



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.12.2018

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7764, DATË
2.11.1993 “PËR INVESTIMET E HUAJA”, TË NDRYSHUAR”**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 dhjetor 2018, shqyrtoi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.7764, datë 2.11.1993, “Për investimet e huaja”, të ndryshuar, propozuar nga Këshilli i Ministrave në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit ishte i pranishëm për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë z. Elton Haxhi dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Përmes këtij projektligji propozohet një ndryshim në ligjin nr.7764, datë 2.11.1993, “Për investimet e huaja”, të ndryshuar, i cili ka në fokus mbrojtjen e posaçme shtetërore për garanci dhe siguri të shtuar juridike ndaj investimeve/investitorëve të huaj, të cilët investojnë në Shqipëri.

Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2010, miratoi disa shtesa dhe ndryshime në ligjin e investimeve të huaja, me qëllim zgjidhjen e problematikave të evidentuara siç ishin dhe konfliktet gjyqësore me palë të treta private, të cilat kishin ndikuar në shtimin e pasigurisë juridike të titujve të pronësisë, duke penguar realizimin e investimit. Konkretisht, amendimet e atij viti fokusoheshin në implementimin e mekanizmave të mbrojtjes së posaçme shtetërore, të cilat parashikonin zëvendësimin me të drejta të plota të investitorit të huaj nga ana e shtetit shqiptar në konfliktin juridiko-civil me palë të treta private. Sidoqoftë, një nga kufizimet e ligjit propozonte që mbrojtja e posaçme shtetërore të ishte e kufizuar në kohë deri më datë 31.12.2014, ndërsa ndryshimet e ligjit nr. 46/2017 e shtynin këtë afat deri në fund të vitit 2018.

Projektligji që po shqyrtojmë sot parashikon ndryshimin e pikës 1, të nenin 11/1 të ligjit, duke e shtyrë afatin e efektshmërisë së mbrojtjes së posaçme shtetërore nga 31 dhjetori 2018 në 31 dhjetor 2019. Ky ndryshim vjen pas ndryshimit të miratuar në tetor të këtij viti në ligjin për

investimet strategjike, i cili zgjati afatin përfundimtar të paraqitjes së kërkesave për përfitimin e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë” deri më 31 dhjetor 2019.

Zgjatja e afatit është parashikuar vetëm për një vit, sepse në të njëjtën kohë po punohet nga insitucionet përgjegjëse për hartimin e një ligji të unifikuar dhe gjithpërfshirës të investimeve të huaja dhe strategjike, në përputhje me rekomandimet e BERZH-it.

Anëtarët e Komisionit gjatë diskutimeve u shprehën se legjislacioni i adoptuar nga vendi ynë përse i përket investimeve të huaja duhet vlerësuar si liberal, duke pasur parasysh që parimi kryesor mbi të cilin mbështetet ligji është mosdiskriminimi ndërmjet investitorëve vendas dhe të huaj. Gjithashtu, Komisioni vlerëson ndryshimet në vitet e fundit të politikave fiskale, të cilat janë fokusuar në tërheqjen e sa më shumë investimeve të huaja ku mund të përmendim incentivimi fiskal për hotelet dhe resortet *brand name* me 4 dhe 5 yje, aplikimi i shkallës së reduktuar të tatimit mbi të ardhurat në masën 5 % për softëaret dhe për çdo subjekt tjetër me të ardhura deri në 14 milion lekë.

Në përfundim të diskutimeve, duke qenë se projektligji nuk sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit dhe nëpërmjet miratimit të tij garantohet mbrojtja e posaçme për investimet e huaja, Komisioni e miratoi atë me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me propozimin për hyrjen në fuqi menjëherë të tij, mbas marrjes së pëlqimit nga Presidenti i Republikës. Në rast se Presidenti nuk do të japë pëlqimin atëherë projektligji do të hyjë në fuqi 15 ditë mbas botimit në Fletoren Zyrtare.

RELATORE

KRYETAR

Evis KUSHI

Erjon BRAÇE